


E TRANCIT

XHEJLANE GJINI

*[Signature]*

DT: 28.03.2017

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministry of Culture, Youth & Sports  
31/2  
22.03.2017



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-**  
**Ministry of Culture, Youth & Sports**

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge**  
**Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**  
**Prizren**

|                        |                                                  |
|------------------------|--------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 28.03.2017                                       |
| REFERENC-Ë:            | Nr. 31/2                                         |
| PËR/ZA/TO:             | Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor |
| CC:                    |                                                  |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                  |
| NGA/OD/FROM:           | Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren          |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë        |

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.10/2017 të dt. 27.03.2017 për lëndën Sherif Tërtinit Nr.04-353-181810 për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 3458 – O.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE  
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA  
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENTS  
123 27.03.2017  
PRISTINE

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

**Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve**  
**Kosovo Institute for the Protection of Monuments**  
**Institut Kosova za zaštitu spomenika**

Nr. 10/2017

Datë: 27.03.2017

Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi i projektit / kërkesës për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale me Nr. 3458 – 0 me pronar Sherif Tërtini – Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e ekspertëve nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Pala, Sherif Tërtini nga Prizreni, ka parashtruar kërkesën për ndërtimin e objektit - shtëpi individuale për banim, etazhiteti P+1 numri i parcelës 3458-0. Kërkesa e tillë në datë 03.02.2017 i është adresuar Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Prizrenit me objekt kërkesë – dhënie e pëlqimit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim me Nr.04-353-181810. Objekti që do të ndërtohet gjendet në zonën e IV (nënkalasë) sipas Planit të Konservimit etazhiteti i lejuar është P+1 (lartësia maksimale deri të streha është 6.5m) dhe për ngastrat deri në 100m<sup>2</sup> për ndërtim mund të shfrytëzohet deri në 100% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjenden Xhamia e Sinan Pashës dhe Shkolla Ortodoske “Bogosllavia” që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2017.

Pas shqyrtimit të hollësishëm të projektit ideor, Komisioni e aprovon atë me kusht që gjatë përpilimit të Projektit Zbatues hapjet të harmonizohen me arkitekturën tradicionale dhe streha të dizajnohet në përputhje me parametrat e përcaktuara në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar aprovimin e Projektit Ideor, për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim, në ngastrën kadastrale 3458 – 0, me pronar Sherif Tërtini, me kushte. Projekti, në parim, i përmbahet kriterëve për ndërtim në zonën e IV (nënkalasë), sipas planit të konservimit.

1. Kërkohet nga pala që gjatë përpilimit të projektit tu përmbahet kushteve:
  - 1.1. Kulmi të ketë strehë të njëtrajtshme me gjerësi 0.8-2m;
  - 1.2. Hapjet të jenë në harmoni me arkitekturën tradicionale

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunitës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

